



A.nr.526/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.526/2026, të datës 13.05.2026, parashtruar nga ankuesi A.A, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat H. S nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Agjencia Kadastrale e Kosovës, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 29.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.526/2026, e datës 13.05.2026, e parashtruar nga ankuesi A.A.
- II. Anulohet** Vërejtja me shkrim me numër protokolli 01/683/26, e datës 05.05.2026, e shqiptuar ndaj ankuesit nga u.d Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës.
- III. Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të tij, duke hequr masën disiplinore të ankueses nga dosja personale e ankuesit.
- IV.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra si në pikën III të dispozitivit.

A r s y e t i m

Ankuesi A.A, (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 13.05.2026, përmes përfaqësuesit të tij, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërejtjes me shkrim me numër protokolli 01/683/26, të datës 05.05.2026, të shqiptuar nga u.d Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, për shkak të shkeljeve ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 02.04.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 26.05.2026, ka përcjell dokumentacionin lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:Ankesën me numër protokollit 2264/2026, të datës 13.05.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.05.2026; Vërejtjen me shkrim me numër protokollit 01/683/26, e datës 05.05.2026;kt Emërimin AE.Nr.01/2022 të datës 01.08.2022 të ankuesit; Autorizimin e datës 30.03.2026;Vendimin e Këshillit A.nr.382/2026 të datës 12.05.2026 Përgjigjen në ankesë e datës 21.05.2026; Emailin e datës 20.05.2026 nga F.K për V.Y; Kërkesën e datës 01.04.2026 nga F.K për ankuesin; Kërkesën e datës 31.03.2026 nga S.K për L.S dhe N.N; Emailin e datës 20.04.2026 nga F.K për N.N, L.S dhe ankuesin; Emailin e datës 20.04.2026 nga D.U për N.N, L.S.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, *sepse*:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Aktit të Emërimit me numër AE.Nr.01/2022 të datës 01.08.2022, është i punësuar në pozitën Drejtor i Drejtoratit të Regjistrimit mbi Pronat e Paluajtshme në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

Sipas shkresave të lëndës, u.d Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, më datë 05.05.2026, përmes aktit me numër protokollit 01/683/26, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore Vërejtje me Shkrim, me arsyetimin se *Departamenti i Kadastrit i udhëhequr nga ankuesi, nuk ka ndërmarr veprimet konkrete lidhur me kërkesën e Zyrës Kadastrale Komunale të Zveçanit të datës 31.03.2026 e cila është përcjell për trajtim më 01.04.2026. Gjithashtu edhe pas kërkesës së përsëritur të datës 20.04.2026, e cila i është përcjell departamentit përkatës, dhe ku është kërkuar që gjatë javës të organizohet trajnim në pjesën tekstuale dhe grafike, nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme nga niveli drejtues i Departamentit. Nga shqyrtimi i komunikimeve zyrtare konstatohet se: nuk është kthyer përgjigje zyrtare ndaj kërkesës dhe rikujtimit; nuk janë ndërmarr veprime për organizmin e trajnimit të kërkuar; nuk është hartuar plan veprimi me afate dhe përgjegjës për realizim; është shpërfillur komunikimi institucional dhe kërkesa e përcjellë nga menaxhmenti. Këto veprime dhe mos veprime përbëjnë mos përmbushje të detyrave të punës, neglizhencë në ushtrimin e funksionit, mos respektim të afateve dhe mungesë bashkëpunimi institucional.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vërejtjes me shkrim me numër protokollit 01/683/26, të datës 05.05.2026, të shqiptuar nga u.d Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, pretendon se masa disiplinore është shqiptuar nga personi i cili është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës në mënyrë të paligjshme kjo e konstatuar edhe me Vendimin A.nr.383/2026 të KPMSHCK-së,të datës 12.05.2026 ,e për rrjedhojë masa disiplinore është shqiptuar nga organi i cili ka vepruar pa kompetencë. Masa disiplinore është shqiptuar pa ndonjë argumentim të gjendjes faktike, sepse nuk ka asnjë mosveprim apo shmangje nga përgjegjësitë sepse qëllimi i trajnimit ka qenë që të organizohet trajnim i përbashkët në përputhje me dakordimet e arritura me përfaqësuesit e komunave përkatëse. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet masa disiplinore, të obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore që masën disiplinore të heq nga dosja personale e tij.

Gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike administrative, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, dhe sipas shkresave të lëndës, rezulton se sipas Vendimit me Nr.06/2026 të datës 25.03.2026 të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, z.F. K, është caktuar ushtrues detyre i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, mirëpo ankuesi më datë 31.03.2025 kundër këtij vendimi, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 13.05.2026, përmes Vendimit

A.nr.383/2026, kishte aprovuar ankesën e ankuesit duke e shfuqizuar Vendimin me Nr.06/2026 të datës 25.03.2026 të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe përkundër faktit që ndaj Vendimit me Nr.06/2026 të datës 25.03.2026, të Ministres së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ishte parashtruar ankesë nga ankuesi, dhe me rastin e parashtrimit të ankesës përveç që ishte njoftuar Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ishte njoftuar edhe Agjencia Kadastrale e Kosovës, mirëpo edhe përkundër kësaj, Vendimi me Nr.06/2026 i datës 25.03.2026, ishte zbatuar, ndërsa meqenëse ndaj këtij vendimi është parashtruar ankesë, atëherë i njëjti nuk ka mundur të bëhet i ekzekutueshëm pa u plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 144 paragraf 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“1.Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me: 1.1. skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar; 1.2. njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit, nuk lejohet ankesa; 1.3. njoftimin e palës me aktin, kur, sipas ligjit, ankesa nuk ka efekt pezullues 1.4. njoftimin e palës me aktin e ndalimit të efektit pezullues të ankesës, në pajtim me paragrafin 3 të nenit 130 të këtij Ligji, apo 1.5. njoftimin e palës për refuzimin e ankesës”,* pra me rastin e parashtrimit të ankesës, organi publik ka qenë i obliguar që të pezulloj çdo veprim që ndërlidhet me këtë vendim, ngase kjo është përcaktuar sipas nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën”.*

Pra Kolegji i Këshillit, nga shqyrtimi i pretendimeve ankimore të ankuesit, konstaton se masa disiplinore ndaj ankuesit, është shqiptuar nga personi i cili nuk ka pasur kompetencë të përcaktuar me nenin 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase caktimi i ushtruesit të detyrës së Agjencisë Kadastrale të Kosovës me Vendimin me Nr.06/2026 të datës 25.03.2026 të Ministres së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ishte konsideruar i paligjshëm nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit A.nr.383/2026 të datës 12.05.2025 bazuar në ankesën e datës 31.03.2026.

Po ashtu Kolegji i Këshillit, konstaton se lidhur me kualifikimin e shkeljeve disiplinore të supozuara të ankuesit, shkelja disiplinore është kualifikuar si mos përmbushje e detyrave të punës, neglizhencë në ushtrimin e funksionit, mos respektim i afateve dhe mungesë bashkëpunimi institucional, nuk korrespondojnë me masën e shqiptuar , ndërsa masa disiplinore e shqiptar ndaj ankuesit Vërejtje me shkrim e paraparë me nenin 57 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë , kur është e argumentuar me prova konkrete i shqiptohet vetëm për shkelje të lehta disiplinore të përcaktuara me nenin 56 paragrafi 3 të këtij ligji.

Përkitazi me konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se akti i kontestuar me ankesë, Vërejtja me shkrim me numër protokolli 01/683/26, e datës 05.05.2026, e shqiptuar ndaj ankuesit nga u.d Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, është në kundërshtim me parimet e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që bazuar në konstatimet si më sipër pretendimet ankimore të ankuesit janë të

bazuara, ndërsa bazuar në dispozitivin e këtij vendimi dhe të mbështetur në arsyetimin e të njëjtit vendim, atëherë Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, është e obliguar të ndërmarr të gjitha veprimet duke hequr edhe masën disiplinore nga dosja personale e ankuesit.

Nga ajo që u tha si më lartë, e duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.526/2026, më datë 29/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokat H.S;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.